

VENDIM
Nr. 228, datë 13.4.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, KRITEREVE DHE AFATEVE PËR
NDJEKJEN E PROGRAMEVE TË FORMIMIT E TË KUALIFIKIMIT
PROFESIONAL, TË AFATEVE TË VAZHDIMIT TË USHTRIMIT TË
PROFESIONIT DHE TË ANËTARËSIMIT NË URDHRIN E PUNONJËSVE
SOCIALË PËR INDIVIDËT QË NUK KANË FORMIMIN E KUALIFIKIMIN
PROFESIONAL MINIMAL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 19, të ligjit nr. 163/2014, “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Individët, të cilët në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 141/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 163/2014, ‘Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë’”, të ndryshuar, ushtrojnë ose kanë ushtruar profesionin e punonjësit social për një periudhë prej jo më pak se 10 (dhjetë) vjetësh e zotërojnë diplomën e studimeve të ciklit të parë në fushën e punës sociale dhe të ciklit të dytë në një fushë tjetër janë të detyruar të ndjekin një program të formimit e të kualifikimit profesional, të përshtatshëm për ushtrimin e profesionit të tyre, në një nga institucionet e arsimit të lartë, publike dhe jopublike, që ofrojnë këto programe studimi. Programet e studimit të përfundohen brenda 3 (tre) vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Pas përfundimit të këtij programi, ata i nënshtrohen provimit të shtetit.

2. Individët, të cilët në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 141/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 163/2014, ‘Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë’”, të ndryshuar, ushtrojnë ose kanë ushtruar profesionin e punonjësit social për një periudhë jo më pak se 10 (dhjetë) vjet e zotërojnë diplomën e studimeve të ciklit të dytë të punonjësit social dhe diplomën e studimeve të ciklit të parë në një fushë tjetër, janë të detyruar të ndjekin një program të formimit e të kualifikimit profesional, të përshtatshëm për ushtrimin e profesionit të tyre, në një nga institucionet e arsimit të lartë, publike dhe jopublike, që ofrojnë këto programe studimi. Programet e studimit të përfundohen brenda 3 (tre) vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Pas përfundimit të këtij programi, ata i nënshtrohen provimit të shtetit.

3. Individët e përcaktuar në pikat 1 e 2 të këtij vendimi, e ruajnë vendin e punës për 4 (katër) vjet nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe kanë të drejtën të bëjnë kërkesën për regjistrim të përkohshëm pranë Urdhrit të Punonjësve Socialë, ku, në përfundim të plotësimit të kriterëve të përcaktuara në pikat e sipërpërmendura, u lind e drejta e anëtarësimit dhe e përfitimit të statusit të punonjësit social.

4. Vendimi nr. 826, datë 7.10.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, kriterëve dhe afateve për ndjekjen e programeve të formimit e të kualifikimit profesional për individët që ushtrojnë profesionin e punonjësit social për një periudhë të caktuar kohe, por nuk kanë formimin dhe kualifikimin profesional minimal për punonjës social”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet ministria përgjegjëse për çështjet sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama